



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1544 Prot.

Tiranë, më 15.12 2017

**VENDIM Nr. 232, datë 13.12.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.13, datë 13.12.2017, pasi shqyrtoi *kërkesën nga FSHZH për ndryshim të vendimit Nr. 211, datë 31.10.2017, të KKA për projektin "Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës", segmenti "Selenicë – Kuç – Qeparo".* përkatësisht shfuqizimin e pikës 3 dhe 4 të tij:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *kërkesën nga FSHZH për ndryshim të vendimit Nr. 211, datë 31.10.2017, të KKA për projektin "Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës", segmenti "Selenicë – Kuç – Qeparo",* përkatësisht shfuqizimin e pikës 3 dhe 4 të tij.
2. Të spostohet gjurma e rrugës në gjatësinë e përfshirë ndërmjet PG.2+071.00 - PG.2+222.00, duke ju larguar Kodrës pranë fshatit Gjorm, ku janë evidentuar gjetje arkeologjike, me qëllim mosdëmtimin dhe ruajtjen e këtyre gjetjeve.
3. Të kryhet nga DRKK Vlorë, Sektori Sarandë ndjekja periodike e punimeve të gërmimit për projektin "Rehabilitimi i rrugës së Lumit të Vlorës", segmenti "Selenicë – Kuç – Qeparo".
4. ASHA të verifikojë raportet e terrenit, të depozituar pranë saj nga DRKK Vlorë, Sektori Sarandë, e cila do të kryejë ndjekjen periodike të punimeve të gërmimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO